

# Kapitulli 1 Shkolla Shqipe

---

## RRUGËTIMI I SHKOLLËS SHQIPE NË SHEKUJT XVII-XIX

*Sipas studiuesve shqiptarë*

**Prof. Asoc. Dr. Eranda HALLUNI BILALI, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”**

**Prof. Dr. Nertila HAXHIA LJARJA, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”**

### **Abstrakt**

Ky punim eksploron historinë e arsimit shqip gjatë periudhës së hershme moderne, duke u fokusuar në sfidat dhe zhvillimet që përcaktuan formimin dhe mbijetesën e shkollave shqipe. Duke analizuar burimet historike, dokumentet bashkëkohore dhe studimet e historianëve, ky punim synon të nxjerrë në pah ndikimin e faktorëve socialë, politikë dhe kulturorë në përpjekjet për ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kombëtar përmes arsimit. Artikulli trajton rolin e institucioneve fetare, veçanërisht të kishave katolike dhe ortodokse, dhe ndikimin e tyre në krijimin e shkollave të para shqipe. Po ashtu, shqyrton ndërhyrjen e fuqive të huaja, përpjekjet për asimilim dhe rolin e intelektualëve shqiptarë në ngritjen e vetëdijes kombëtare për nevojën e arsimit në gjuhën shqipe. Duke analizuar këto elemente, artikulli synon të ofrojë një kuptim më të thellë të dinamikave komplekse që ndikuan në rrugëtimin e shkollës shqipe nga shekulli i XVII deri në pragun e Pavarësisë.

*Fjalë çelës: shekulli XVII-XIX, shkolla shqipe, institucione fetare, identitet kombëtar, intelektualë*

### **The Path of the Albanian School in the 17th-19th Centuries**

*According to Albanian Scholars*

### **Abstract**

The paper "The journey of albanian Schools in the 17th-19th centuries according to albanian scholars" explores the history of albanian education during the early modern period, focusing on the challenges and developments that shaped the formation and survival of albanian schools. By analyzing historical sources, contemporary documents, and the studies of historians, this paper aims to highlight the impact of social, political, and cultural factors on efforts to preserve the language and national identity through education. The article addresses the role of religious institutions, particularly catholic and orthodox churches, and their influence on the creation of the first albanian schools. It also examines the intervention of foreign powers, attempts at assimilation, and the role of albanian intellectuals in raising national awareness about the need for education in the albanian language. By analyzing these elements, the article aims to provide a deeper understanding of the complex dynamics that influenced the journey of albanian schools from the 17th century to the threshold of Independence.

*Keywords: 17th-19th centuries, albanian schools, religious institutions, national identity, intellectuals*

## Hyrje

Studiuesit vënë në dukje se në trevat e Arbërit, shkollat e para lindën që në shekullin e XVI, si rezultat i lulëzimit që kishin arritur qytetet shqiptare në Kosovë, në zonën e Shkodrës, në atë të Krutës, të Himarës, etj. Ata ishin shkolla elementare, ku nxënësit mësonin lexim, shkrim, elemente të historisë etj. Gjuhë mësimi ishte fillimisht italishtja dhe më vonë, aty nga mesi i shek. XVII, filloi të përdorej gjuha shqipe. Numri i nxënësve si dhe kohëzgjatja e mësimi ishte e ndryshme. Shkollat themeloheshin zakonisht në famulli, pranë kishës ose në shtëpinë e famullitarit. Mësues ishin famullitarët, shqiptarë të cilët shkolloheshin nëpër kolegje dhe institucione të tjera arsimore në Itali, por edhe të huaj.

## Shekulli XVII

Në shek.XV-XVII banorë të viseve të ndryshme ishin vendosur në Himarë, në përpjekje për ti shpëtuar pushtuesit dhe kështu do ta kishin më të lehtë për të emigruar. Krerët e Himarës iu drejtuan mbretit të Napolit, Papës së Romës, Spanjës, Polonisë e Ruisë, për ndihmë materiale. Në këto kushte Papa dërgon misionarët e vet, kryesisht arbëreshë e me kombësi të tjera që e dinin shqipen.

Kështu, në vitin 1627, në Himarë u hap një shkollë shqipe nga një mision katolik oriental, shkollë që u riorganizua më 1660. Kjo shkollë luajti një rol të rëndësishëm për mësimin e shqipes. Në këtë shkollë një rol të rëndësishëm ka luajtur Neofit Rodino<sup>1</sup> (misionar i dërguar nga Papa, që meshonte në ritin ortodoks, shënimi ynë), i cili qëndroi aty nga viti 1627 deri më 1643. Në një letër Neofit Rodino, midis të tjerave thotë: "Jam kurdoherë midis malësorëve të mi të dashur gjithnjë i zënë për t'i evangjilizuar dhe për të mësuar fëmijët e tyre"<sup>2</sup>. Në shkollën e Himarës vinin nxënës nga Saranda, Lukova, Nivica, Piqerasi, Shën Vasili, Lëkurasi...etj. Petro Marko shkruan: Sipas Vinçes Rodotas, Rodinoja "ka qenë i pari mësonjës dhe drejtonjës i misionit në këtë krahinë...Këta banorë nuk shkonin në meshë, nuk dinin as formulën e pagëzimit...Shkonte falas fshat më fshat, punonte e lodhej shumë, e veçanërisht me punën e shkollës..."<sup>3</sup> Si misionarë të mësimi në shkollë punuan edhe italiani Nilo Katalano (1637-1694) dhe arbëreshi Giuseppe Sqirò (1690-1780). Giuseppe Sqirò punoi në shkollat shqipe të bregdetit afër një çerek shekulli. Ai i mësoi nxënësve greqisht, latinisht e shqip. "Ua mësonte doktrinën e krishterë, si dhe shkrimin greqisht e shqip"<sup>4</sup>. Është për tu theksuar se po të shohim listën e krerëve të misioneve, nga i pari, Neofit Rodinò-së, në vitet 1630, tek i fundit, Giuseppe Sqirò, që u mbyll në vitin 1773, vihet re qartazi një shqiptarizim progresiv i ekipeve të dërguara në Himarë. Duke filluar nga Filloteo Zassi, arbëresh i Siqilisë, njohës i shkëlqyer i gjuhës shqipe, e duke vazhduar me Basilio Matrangën e Giuseppe Sqirò-në, krerët e misioneve u përzgjedhën mes arbëreshëve.<sup>5</sup>

Më 1724 murgu bazilian Giuseppe Sqirò, i porsa kthyer nga një mision i gjatë në Shqipëri, hartoi një relacion, në të cilin tregonte se në trevën e gjerë të Himarës ekzistonin 15 fshatra, prej të cilëve vetëm tre ishin grekë, por që flisnin edhe shqip, kurse të tjerët ishin shqiptarë dhe nuk e njihnin fare gjuhën greke. Pikërisht i nisur nga ky realitet Neofit Rodino, më 1629 i kishte komunikuar Kongregacionit nevojën për të shtypur "një libër mbi mënyrën se si duhen rrëfyer mëkatet"<sup>6</sup>. Përsa i përket literaturës së katekizmit, që i drejtohej besimtarëve të thjeshtë, mund të thuhet se misionarët punuan për ta përcjellë

<sup>1</sup> "Sa për popullin e tij të dashur, ishte e kollajshme që të kujtohej ky prift i mirë, nga librat që ky i shkruante dhe i botonte falas...Kjo do të thotë se ky në shkollë kishte përgatitur njerëz që i këndonin librat e tij" Marko P, "Shkolla e parë shqipe tre shekuj më parë", Fletë nga historiku i shkollës, Tiranë, 1962, fq. 8

<sup>2</sup>Po aty

<sup>3</sup> Po aty

<sup>4</sup> Sulë Dedei, "Zhvillimi i arsimit në Mesjetë në Shqipëri", Revista Pedagogjike, nr.2, viti 1999, Tiranë, fq.106-107

<sup>5</sup> Karalewskij, C, "La msione greco-cattolica della Cimarra nell'Epiro nei sec.XVI-XVII", në "Bessarione", anno XV, fashik.2, 1911, fq. 441. (cit. Nga Xhufi, P., "Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII", "Dukuri të shkollës e të gjuhës në Shqipërinë e Poshtme (shek. XIV-XVIII)", Tiranë, 2013, fq.49.)

<sup>6</sup> Xhufi, P., "Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII", "Dukuri të shkollës e të gjuhës në Shqipërinë e Poshtme (shek. XIV-XVIII)", Tiranë, 2013, fq.56.

atë në gjuhën shqipe. Përkundrazi, lidhur me botimin e librave të dogmës, që i drejtoheshin klerit të lartë ortodoks, misionarët përdorën përgjithësisht greqishtën vulgare (in lingua graeca vulgari).<sup>7</sup>

Edhe në Dhërmi, më 1660, u themelua një shkollë nga misionari nga Kostandin Onofrio, arbëresh nga Piana e Siçlisë "...Në Dhërmi at Onofrio shkollën e mronte me anë të kavalier Ninas. Këtu merrte pjesë një numër i madh i rinisë...".<sup>8</sup> Sipas dokumenteve, më vonë në këtë shkollë arriti De Kamilis Xhovani i cili jepte mësim në shkollë ku kishte një numër të madh nxënësish. Në një letër, midis të tjerash, shkruan: "Himariotët më kanë shkruar lutje....që të shkoj tek ata për të dhënë mësim në shkollë, po unë do të qëndroj këtu në Dhërmi..."<sup>9</sup>

Sipas dokumenteve të kohës ky klerik më vonë dha mësim edhe në shkollën e Himarës, bile kishte fituar një emër të mirë në gjithë zonën. Është për tu theksuar se misionarët lexonin librin e Pjetër Budit në shqip, prandaj do të mësonin në shkollë në gjuhën shqipe. Në këtë shkollë punoi edhe Nilo Katalano, i cili për mësimin shqip në këtë shkollë hartoi një gramatikë dhe një fjalor italisht-shqip. "Gramatikën shqipe Nilo Katalanua e bëri për 80 nxënësit e tij të shkollës së Dhërmiut".<sup>10</sup> Kjo shkollë kishte fituar nam të madh sa vinin nxënës edhe nga Dukati, Tërbaçi etj.

Më 1632 kemi një shkollë në Kurbin të Krujës, ku mësohej shqip.<sup>11</sup> Kjo është e para shkollë në territorin e Vilajetit të Shkodrës, guri i sigurtë e historik i themelit të shkollës shqipe<sup>12</sup>. Shkollën e vijnë një numër i vogël nxënësish. Shkolla duhet të jetë mbyllur më 1650. Në relacionin e datës 20. XII. 1641 që arqipeshkvi i Durrësit, Mark Skura, i drejton Kongregacionit të Propagandës Fide (Congregatio de Propaganda Fide, institucion në gjirin e Vatikanit shkruhet "Ka një shkollë me 12 gjakoj që arqipeshkvi i ushqen me mjetet e veta për të rritë subjekte që të shugurohen meshtarë pastaj kur të jetë koha"<sup>13</sup>, ndërsa në relacionin që prefekti i misioneve françeskane të Shqipërisë më 7. III. 1650 i dërgon Kongregacionit, thuhet: "...duke u mësuar fëmijëve shkrim e këndim, e disave gramatikë"<sup>14</sup>. Mbështetur në dokumentet e mësipërme arrijmë në përfundimin që në Kurbin ka ushtruar veprimtarinë e vet një shkollë me 12 nxënës, e cila ka zënë fill më 1632 dhe është mbyllur më 1650. Ajo e ka filluar jetën e vet si shkollë fillore, e më vonë mund të jetë kthyer në kolegji (shkollë e mesme). Shkolla e gramatikës, për të cilën flet dokumenti, në sistemin mesjetar të mësimin, vinte fill pas shkollës fillore.<sup>15</sup> Për programet që zbatonte kjo shkollë në procesin mësimor, flet "Fjalori enciklopedik shqiptar" i vitit 1985. Aty shkruhet: "Shkolla e Kurbinit. Një ndër shkollat e para shqipe, e themeluar më 1632 në afërsi të Krujës, që i përkiste vilajetit të Shkodrës. Përveç leximit e shkrimit aty jepej edhe mësimi i gramatikës. Përdoreshin si tekste mësimore edhe veprat e Frang Bardhit, Pjetër Budit, Pjetër Bogdanit, e të ndonjë tjetri, në gjuhën shqipe. Pushtuesit e penguan veprimtarinë e saj deri sa e mbyllën".<sup>16</sup> Qëllimi i saj nuk ishte vetëm përgatitja e atyre nxënësve që më vonë do të shuguroheshin meshtarëve, por këta meshtarë të rinj do të kryenin edhe detyrën e mësuesit, pra, do të përhapnin kulturën dhe arsimin në popull.<sup>17</sup> Kjo

<sup>7</sup> Karalewskij, C (1911) La missione greco-cattolica della Cimarra nell'Epiro nei sec.XVI-XVII, nw "Bessarione", anno XV, fashik.2 Karalewskij, C, "La missione greco-cattolica della Cimarra nell'Epiro nei sec.XVI-XVII", në "Bessarione", anno XV, fashik.2, 1911, fq. 480-481. (cit. Nga Xhufi, P., "Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII", "Dukuri të shkollës e të gjuhës në Shqipërinë e Poshtme (shek. XIV-XVIII)", Tiranë, 2013, fq.57.)

<sup>8</sup> Marko, P. "Shkolla e parë shqipe tre shekuj më parë", Fletë nga historiku i shkollës, Tiranë, 1963, fq.8

<sup>9</sup> Marko, P. "Shkolla e parë shqipe tre shekuj më parë", Fletë nga historiku i shkollës, Tiranë, 1963, f. 9.

<sup>10</sup> Marko, P. "Shkolla e parë shqipe tre shekuj më parë", Fletë nga historiku i shkollës, Tiranë, 1963, f. 9.

<sup>11</sup> Kastrati, J. "Tekste të vjetra shkollore...", Arsimit popullor, nr.6, 1964, f.134

<sup>12</sup> Çefa, K., "Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII", "Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVIII", Tiranë, 2013, f. 102.

<sup>13</sup> Relacioni i Mark Skurës drejtuar kongregacionit të Propagandës Fide mbi vizitën e kryeme nëpër dioqezat e Shqipërisë së mesme, në vëllimin "Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII", vëllimi II(1634-1650), Tiranë, 1965, f. 241.

<sup>14</sup> Pjesë nga Relacioni i prefektit të misioneve françeskane në Shqipëri drejtuar kongregacionit të praragandës Fide(7 mars 1650), në "Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë", vëll. III (1506-1839), Tiranë, 1962, f. 193

<sup>15</sup> Luka, D., "Shkolla shqipe e Kurbinit", Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVII, Tiranë, 2013, fq.31.

<sup>16</sup> Fjalori enciklopedik shqiptar, "Osmani.Sh" Tiranë, 1985, f. 1021.

<sup>17</sup> Luka, D. (2013) "Shkolla shqipe e Kurbinit", "Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVIII", Tiranë, f. 37.

shprehet qartë në relacione që daton vitin 1632, ku shkruhet "...ata çuna...pasi të nxanë, do të baheshin mësues për të tjerë".<sup>18</sup> Në shkollën e Kurbinit krahas leximit, shkrimit e gramatikës mësohej edhe gjuha latine, katekizmi e doktrina kristiane.

Shkolla të tilla pati edhe në Korçë, e themeluar në vitin 1637.<sup>19</sup> Ekziston mendimi se është shkolla më e vjetër. Prindërit paguanin taksa shkollore. Pas kësaj njihen edhe dy shkolla të tilla në Lezhë, të cilat ngrihen nga një ekip misionarësh françeskanë, që u vendosën aty në çerekun e dytë të shek.XVII. Më 1638 P. Hiacinti a Sospitello O.F.M italian, pati guximin dhe iu përvesh për të mirë të vendit një pune në vështrim të plotë kulturor, duke çelur shkollën fillore në Pllanë, (në atë kohë vend mjaft i banuar afër lumit Mat) e cila frekuentohej nga fëmijë të moshës 8-10 vjeç. Sipas njohësve të kësaj periudhe kjo shkollë, për vetë sukseset që arriti, tërhoqi nxënës edhe nga viset e tjera, deri edhe nga Zadrима. Numri i nxënësve të jashtëm arriti në 25, fakt ky që na bën të mendojmë se duhet të kishte pasur edhe konvikt. Midis mësuesve të kësaj shkolle përmenden P. Filipi da Locarno O.F.M., Karl Mirandulani, Gjon Shqiptari, P. Sebastjani a Roveta O.F.M e P. Bernardni nga Roma<sup>20</sup>. Shkolla u mbyll pas dhjetë vjetësh (1648), por një vit më pas u hap përsëri me kërkesën dhe këmbënguljen e banorëve dhe vazhdoi deri më 1675. Pas një ndërprerje të shkurtër ajo u çel përsëri më 1697 dhe vazhdoi edhe pas mbarimit të shekullit XVII. Themeluesit e kësaj shkolle ngritën edhe një gjimnaz<sup>21</sup> që filloi të ndiqej nga shumë të rinj që dëshironin të bëheshin klerikë. Sipas një relacioni të P. Hiacinti a Sospitellos e Benedikt Travizanus, misioni kishte ndërtuar shtatë hospice. "Në të gjitha këto vende, misioni ka qenë me shumë fitim...tue u mësue fëmijëve këndim e shkrim dhe disave gramatikë".<sup>22</sup> Ata filluan mësimet me ato mjete që kishin domethënë me dorëshkrime etj. Nga dokumentet mësojmë se këtu, përveç mësimave fetare, jepej edhe letërsi, pa përjashtuar gjuhën amtare.<sup>23</sup>

Hapja e shkollave në Pllanë pati jehonë të madhe. Paria e Blinishtit iu drejtua misionarit françeskan P. Bonaventura da Palazzolo për të hapur një kuvend dhe shkollë në fshatin e tyre, por kur kjo kërkesë nuk u realizua, ata iu drejtuan kuvendit të Troshanit, i cili, rreth vitit 1639 dhe pas konsultimit me Ipeshkvin e Sapës, hapi një kuvend dhe një gjimnaz në Blinisht të Zadrimes me 50 nxënës që nga fillimi.<sup>24</sup> Drejtor i kësaj shkolle u emërua P. Karl Mirandulani O.F.M., i cili kishte aftësi të veçanta për të mësuar moshën e re. Meqë kjo shkollë frekuentohej nga fëmijë dhe të mëdhenj, zhvillimi i lëndëve niste duke u shpjeguar në gjuhën shqipe (lingua vernacula). Mësimi që bëre me shumë rregullsi, saqë vetë turqit u thonin banorëve të Blinishtit : "Shtazët ua patën bre germat e t'ueja veç se këta fretën rishtas ua njallën"<sup>25</sup>. Në këtë shkollë përveç shkrimit dhe këndimit mësoheshin edhe lëndë të tjera. Në përmbajtjen e lëndëve përfshihej edhe gjuha shqipe, ndërsa gjuha latine mësohej vetëm nga ata që do të bëheshin meshtarë. Si tekste mësimore këtu janë përdorur dorëshkrime dhe vepra të Andrea Bogdanit, Pjetër Budit, Frang Bardhit, Pjetër Bogdanit etj.<sup>26</sup> Mendohet se kjo shkollë nuk pati jetëgjatësi për faktin se P. Karli aty nga mbarimi i vitit 1640 është mësues në shkollën e Pllanës.<sup>27</sup>

Me vlerë është edhe informacioni i vitit 1641, ku Gjergj Bardhi njofton se gjatë një vizite në Kosovë, në vendin e quajtur Gurrë, ku ishte famullitar Don Andrea Bogdani, kishte takuar dy

<sup>18</sup> "Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në Shekullin e XVII", vëllimi II (1634-1650), Tiranë, 1965, f. 371.

<sup>19</sup> Koliqi, H (2012) "Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar", Prishtinë, f. 90.

<sup>20</sup> Mons Spila, Memorie storiche d. Prov. R. Romana, tom. II, p. 316-317, ss. n. 2

<sup>21</sup> Kastrati, J. "Tekste të vjetra shkollore...", Arsimi popullor, nr.6 , 1964, f. 49.

<sup>22</sup> Skura, M (1965)"Reacion i Mark Skurës drejtue Kongregacionit të Propagandës Fide mbi vizitën e kryeme nëpër dioçezet e Shqipënisë së Mesme", vëll.II (1634-1650); Në Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të mesme sh. XVII, V. II, (1634-1650),Tiranë, 1965, f. 395.

<sup>23</sup> Kastrati, J., "Tekste të vjetra shkollore...", Arsimi popullor, nr.6 , 1964, f. 49.

<sup>24</sup> Dedei, S., "Zhvillimi i arsimit në mesjetë në Shqipëri", Revista Pedagogjike , nr 2, 1999, f. 103.

<sup>25</sup>Orbis Seraphicus, P. Marcellinus a Civetia et Theophilus Domenichelli O.F.M De Miss, FF. Minorum. Lib. IV, f. 443, n. 50

<sup>26</sup>Osmani, Sh. (1998). *Reflekte etnopedagogjike* 1, Tiranë, f. 49.

<sup>27</sup> P. Donat Kurti, O.F.M. "Vepra kulturele e elementit katolik në Shqipëri", Shkodër, 1935, f. 7.

seminaristë, që ai mbante në shtëpinë e tij dhe i mësonte vetë. Theksoj se ky prijës i Bogdanëve<sup>28</sup>, arkipeshkvi i Shkupit shquhet për veprimtarinë e tij arsimore në drejtim të "shkollimit e kuadrove të reja në vend dhe jashtë Kosovës, funksionimin e shkollave pranë çdo famullie, sigurimin e disa bursave për kandidatë shqiptarë në Loreto dhe Propagandën e Romës, hartimin e librave shkollorë dhe homolikë në gjuhën shqipe."<sup>29</sup>

Shkolla e Velës (sot në territorin e Mirditës) është hapur pas vitit 1660 nga ipeshkvi i Lezhës, Gjergj Vladanji, i cili rrjedh nga një familje fisnike nga Shiroka e Shkodrës, por me origjinë nga Drishti. Bolica më 1650 shkruan "Gjergj Vladanji ka veti të virtytshme dhe ka njohuni, njeh gjuhën ilirike dhe gjuhën shqipe, rrjedh nga një farefisni shumë e mirë, sa edhe turqit e Shqipnisë e çmojnë sadopak".<sup>30</sup>

Në relacionin e Ipeshkvit Anton Kryeziut më 1753 thuhet: "Në Velë më 1773 gjindet edhe e vetmja shkollë për brezin e ri kishtar në dioqez. Ajo qe ndërtue nga Propaganda Fide dhe kishte 6-8 nxanës dhe një mësues..." Më poshtë ai thekson: "... Përballë padijes së madhe të klerit, që dëshmohej edhe gjatë vizitës, një shkollë e tillë ishte e domosdoshme, me randsi të veçantë. Sipas lajmeve vjetore, aty studjoshin 6 të rij dioqezanë (Jak Stampaneo, Gjon Cura, Gjerard dhe Anton Xiupa, Zef Trashi, si dhe Gjon Bjanku. Veç këtyne, Ipeshkvi kishte edhe 4 të rij të tjerë në shtëpinë e vet, që ai i përgatiste për karrierën kishtarë. Mësimi zhvillohej në shkollë, që me krenari e quejshin gjimnaz. Jepeshin këto landë mësimore: lexim e shkrim, italisht e latinisht..."

Në një tjetër dokument i datës 23.08.1663 na flet për një mësues të gjuhës shqipe në Lezhë, Don Gjon Csulio. Po në këtë vit prifti Pjetër Mazreku, nxënës i Kolegjit Urban është misionar dhe mësues për gjuhën shqipe në shkollën e Janjevës në Dioqezën e Shkupit. Lëndët që zhvilloheshin në atë shkollë ishin, lexim, shkrim doktrinë kristiane e gramatikë. Librat që përdorshin ishin: "Ungjilli në gjuhën shqipe", "Pasqyra e të Rrëfyemit", "Ritual i Romak", "Doktrina e vogël", të gjitha në gjuhën shqipe.

Në një dokument në Arkipeshkëvinë e Durrësit i cili daton vitin 1675, flitet për një mësues të gjuhës shqipe në Kishën e Kurbinit. Të tjera dokumenta na dëshmojnë për Nikollë Vladanjin dhe Pjetër Perlatin si mësues të gjuhës shqipe në Dioqezën e Lezhës.

## Shekulli XVII-XVIII

Një zhvillim i mbarë kulturor e arsimor vërehet në shekujt XVII-XVIII. "Përveç priftërisë, që kanë luajtur rol dhaskali në të gjitha kohësitë, dokumentet arsimore-historike na dëshmojnë se kalamanët e Korçës, fjala vjen, paskan voziturë në shkollë private dhe me dhaskalë laikë, që sot e treqind vjet të shkuara" dhe më poshtë thuhet se "... 'skolëra' me pagesë pat pasur, punë kjo që fëmijët e të vobektëve i linte pa gramë, apo siç duket dhe për fëmijët e punëtorit të esnafërisë mësimi privat është i shtrenjtë. Kjo e metë e madhe ka ngucur ata korçarë të vjetër, "të shtien aspra isnafërisht" për pagesën e dhaskalit".<sup>31</sup> Një i tillë është akti, me anë të të cilit shtatë ryfetët (esnafët) e Korçës, vendosën t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë pa pagesë "duke marrë përsipër të paguajnë 200 aspra për mësuesin". Në këtë mënyrë këto shkolla nuk i ndiqnin vetëm fëmijët e pasanikëve, por edhe ata nga shtresat e popullit, pra kemi përpjekje për t'i dhënë shkollës karakter demokratik.

Në shekullin e XVII, sipas studiuesit J. Rexhepagiqit, në territorin e Kosovës kanë funksionuar shkollat në Janjevë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Suharekë, Glllogjan, Poçest, Papaz e Landovicë. Për shkollat e gjashtë vendbanimeve të fundit ka merita të veçanta Dom Gegë Mazreku. Në shkollën e Janjevës, në

<sup>28</sup>Koliqi, H. (2012). *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*. Prishtinë, 2012, f. 91.

<sup>29</sup>Sedaj E. (1999). *Ndre Bogdani. Prelat e lartë i Kishës dhe mësues i popullit shqiptar*. "Dardania sacra"1, "Shtufi" Prishtinë, f. 275.

<sup>30</sup>Skura, M. "Relacion i Mark Skurës drejtue Kongregacionit të Propagandës Fide mbi vizitën e kryeme nëpër dioqezat e Shqipërisë së Mesme", vëll. II (1634-1650); Në Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme shek. XVII, V. II, (1634-1650), Tiranë, 1965 f. 405.

<sup>31</sup> MASH, "Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar", vëll. I, Tiranë, 2003, f. 58.

vitin 1666, mësues ishte Pjetër Mazreku së këndejmi edhe mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe.<sup>32</sup> Lëndët mësimore që zhvilloheshin në shkollë ishin: lexim, shkrim, doktrinë kristiane, gramatikë. Ndërsa si libra janë përdorur ungjilli në gjuhën shqipe, "Pasqyra e të Rrëfyemit", "Rituali Romak", "Doktrina e vogël", të gjitha në gjuhën shqipe.<sup>33</sup> Raporte të shumta të prelatëve tanë flasin për shkollën shqipe në Kosovë edhe përgjatë shekullit XVIII, siç mësojmë nga raporti i Imzot Gj. N. Kazazit (1747), i cili në banesën e tij po mësonte shtatë fëmijë të moshave nga 7-18 vjeç, ndërkaq Don Zef Berisha, në raportin e 22majit 1782, falënderon Kongregatën për librat e dërguar në gjuhën shqipe, për shkollën në Gjakovë<sup>34</sup>.

Në një kohë kur nevoja për mësimin shqip dhe përgatitjen e klerikëve vendas ishte në rritje, shkolla e Velës synonte të ndërthurte detyrat fetare me ato patriotike, duke formuar klerikë të devotshëm ndaj kishës dhe atdheut, ndërsa programi shkollor përfshinte mësimin e shkrimit dhe këndimit në shqip, gramatikën dhe gjuhën latine, duke e tejkaluar nivelin e një shkolle fillore. Shkolla e Velës ka qenë në nivelin e një "gymnasiumi". Për shkollën e Velës na flet relacioni i Ipeshkviut Anton Kryeziut më 1753. Ndër të tjera ai thekson: "Përballë padijes së madhe të klerit, që dëshmohej edhe gjatë vizitës, një shkollë e tillë ishte e domosdoshme, me randsi të veçantë. Sipas lajmeve vjetore, aty studjoshin 6 të rij dioqezanë (Jak Stampaneo, Jak Cura, Gjerard dhe Anton Xiupa, Zef Trashit, si edhe Gjon Bjanku). Veç këtyne, Ipeshkvi kishte edhe 4 të rij të tjerë në shtëpinë e vet, që ai i përgatiste për karrierën kishtarë. Mësimi zhvillohej në shkollë, që, me krenari e quejshin gjimnaz. Jepeshin këto landë mësimore: lexim e shkrim, italisht e latinisht..."<sup>35</sup>

Një nga njerëzit më të ditur, vullnetmirë, pasionantë të cilin nuk mund ta lëmë pa përmendur është Bogdani. Ai më 1671 u vendos në malet e Rrjollit dhe aty themeloi shtëpinë ipeshkvnore, një kishë dhe një shkollë për të rinj. Me rëndësi për studimin tonë janë letrat që i dërgonte eprorëve në Vatikan dhe pikërisht te interesimi i tij për arsimimin e popullit. Ai tregon dëshirë të madhe për hapjen e shkollave. I lutet Kongregacionit të Propagandës Fide t'i dërgojë një mësues shkolle, përveç atij të Rrjollit, edhe një për fshatin Barbullush, kërkon me këmbëngulje t'u krijoheshin mësuesve kushte të mira, përpiket vetë të zgjedhë elementin më të vlefshëm, i kërkon edhe libra..."*Se asht gati krejt pa libra në gjuhë të vet*".

"Në v. 1698 a aty pari gjejmë se P. Filipi prej Shkodret O.F.M. çilë shi në Shkodër një shkollë private e mson fmit e tregtarëve e të pasanikve."<sup>36</sup> Në revistën "Hylli i Dritës", Patër Anton Gega shkruan "Një shkollë tjetër, krejt private, na del në shesh në Shkodër nga mbarimi i këtij shekulli" (bëhet fjalë për fundin e shek. XVII, shënimi im E.B.). "P. Filip de Locarno kishte marrë me vedit një djaloç prej Shqipnie, i cili mbaroi këndimin me 19.08.1698, kje shugurue meshtar e i thoshin émnit P. Filipi prej Shkodre. Aso kohe, familja e Kolë Kamsit (Cola Cambesi) tue kenë e dame në shej për bâmirësi ndaj misionarvet, xuer lejen prej ipeshkviut të Tivarit, që P. Filipi t'u shenjonte në Shkodër. Por sa mbririni, me një herë P. Filipi xûni vend në shpí të familjes Kamsi, çili një shkollë për me msue fmit, ashtu u shërbej edhe katolikvet"<sup>37</sup>. Në shekullin XVII në shtëpinë e Kamsejve mësimet bëheshin në gjuhën shqipe.

Më 1749 Pal Pemë Kamsi në relacionet dërguar eprorëve të vet në Romë, u përshkruan vështirësitë në hapjet e shkollave dhe i propozon të ngrihet një shkollë e përbashkët për dy dioqezat në Lezhë, e cila shqetësohej më pak nga turqit. Secila dioqez të çonte nga 6 nxënës. Këta të mësohen nga

<sup>32</sup> Gjergji, S., Stublla me Kolegjin e Shën Lukës, 1584, "Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVIII", Tiranë, 2013, f. 69.

<sup>33</sup> Çefa, K., "Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII", Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVII, Tiranë, 2013, f. 124.

<sup>34</sup> Rexhepagiq, J. (1970) "Zhvillimi i arsimit dhe sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në teritorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918", Prishtinë, 1970, f. 48-52

<sup>35</sup> Çefa, K. "Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII", Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVII, Tiranë, 2013, f. 109.

<sup>36</sup> Kurti, D. & Sirdani, M. "Mbi kontributin e elementit katolik në Shqipëri", Tiranë, 1999, f. 13.

<sup>37</sup> Gegaj, A. "Vepra arsimore e françeskajvet në Shypni në shekullin e XVII", Revista "Hylli i Dritës", viti VIII, 1932, Nr. 3, f. 138.

një mësues. Shkolla duhet të jetë në qelë e mësues një rregulltar. Ndërsa për Shkodrën, Kamsi mendonte se vendi më i përshtatshëm ku mund të hapej një shkollë ishte Pulti, larg zullumeve turke. Më 1785 Imzot Radovani u përpoq të hapte një shkollë në Shkodër po dështoi se popullsia myslimane nuk duronte në lagjet tyre as qelë, as shkollë<sup>38</sup>

Përdorimi i gjuhës shqipe u vërejt edhe në shkollat turke. Në fundin e shekullit XVI hapen shkollat e para turke, ndërsa në shekullin e XVII numri i tyre rritet me shpejtësi.

Si forma të organizimit të punës së shkollës në vendin tonë ishin mejtepet dhe më vonë medresetë.

Shtirjen e shkollave që administrohen nga kleri musliman në shek.XVII e jep funksionari i Portës së Lartë, Evlia Çelebi (1611-1684) në librin e tij Udhëtimet, 1930, përkthyer pjesërisht në gjuhën shqipe nga Sali Vuçiterni.<sup>39</sup> Ndër të tjera ai pohon se gjatë vizitave në qytete dhe qendra të tjera të vogla ka gjetur shkolla që ndiqeshin nga një numër i konsiderueshëm nxënësish. Pranë çdo institute të kultit në Shqipëri, -pohon ai,-ka shkolla (mejtepe e medrese) Sipas tij në këto shkolla mbizotëronte të mësuarit përmendësh dhe nxënësit shqiptarë ishin të zgjuar. Gjithashtu ai na jep këtë panoramë të përhapjes së këtyre shkollave sipas rretheve: Shkodër 10 medrese, Delvinë 3 medrese dhe 3 mejtepe, Gjirokastrë 3 medrese dhe 5 mejtepe, Berat 5 medrese dhe 4 mejtepe, Vlorë 3 medrese dhe 5 mejtepe, Kavajë 2 medrese dhe 3 mejtepe, Peqin 3 medrese dhe 5 mejtepe, Elbasan 3 medrese dhe ? mejtepe, Pogradec 1 medrese dhe 2 mejtepe. Siç shihet shkolla të rangut fillor e mbifillor kishte kudo në Shqipëri. Megjithëse ato nuk ishin në gjuhën shqipe, ndjekësit e tyre morën elementin e lexim-shkrimit dhe të kulturës, në kushtet e mungesës së shkollave në gjuhën amtare. Ata arritën të vazhdojnë shkollat jashtë dhe mbuluan rrjetin e nëpunësve të vendit.

Gjatë periudhës 1453-1821 shumica e shkollave greke në Shqipëri ishin shkolla komunale fillestare, drejtoheshin nga priftërinjtë ose edhe nga artizanë zhvillonin mësim brenda në kishë. Në këto shkolla mësohej leximi i veprave kishtare e klasike, aritmetikë e shkrim. Programet në këto shkolla ndryshonin sipas aftësive të mësuesit.<sup>40</sup> Vajzave nuk u jepej një arsim i veçantë, por vetëm disa elemente të punëve shtëpiake.

Në vitin 1749 është rasti i themelimit të një shkolle në Shqipërinë e poshtme nga privatë. Atë vit, tregtari Spiro Rizo nga Delvina, me banim në Venedik, veç të tjerave, la me testament edhe ndërtimin e një shkolle në vendlindjen e tij, Delvinë.<sup>41</sup> Krahas mësimi të lëndëve të përgjithshme (enciklopedike), në shkollë do të mësohej edhe greqishtja. Mësues i saj përmendet edhe murgu Maksim nga fshati Derviçan i Gjirokastrës. Po jo vetëm në Delvinë, por edhe në vise të tjera ku funksiononin shkolla greke, si në Himarë, Paramithi, Margëlliç, mjedisi njerëzor ishte shqiptar, ose kryesisht shqiptar. Mes shqiptarëve ekzistonte tashmë një vetëdije, më së paku e gjuhës.<sup>42</sup> Në përplasjen mes gjuhës së folur e gjuhës së kishës, mes klerikëve të huaj (grekë), që nuk njihnin gjuhën e vendit dhe që kërkonin të impononin helenizmin, dhe klerikëve vendas, të mbështetur nga popullsia vendase, ndërfutet edhe përdorimi i gjuhës shqipe në veprimtarinë kishtare në arealin e jugut. Dëshmia e parë deri më sot mbetet Perikopeja Ungjillore e meshës së Pashkëve, një tekst shqip për të cilin ne kemi folur më sipër. Botimi i fjalorëve 2,3 e 4 gjuhësh i Kostë Beratit, Teodor Kavaljotit e Danil Voskopojarit, përpjekjet e para për përkthimin e Biblës dhe tentativat për sajimin e alfabetëve të gjuhës shqipe janë një provë implicite e institucionalizimit të gjuhës shqipe si gjuhë shkolle, dhe si gjuhë e kishës. Të tilla lëvizje të mëdha

<sup>38</sup> Çefa, K. "Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII", Shkollat shqipe të trevave shqiptre në shekujt XVI-XVII, Tiranë, 2013, f.112

<sup>39</sup> Çelebi, E (1930) "Seyahaname" Shqipëria para dy shekujsh, Tiranë, 1930

<sup>40</sup> Grup autorësh, MASH (2003). "Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik Shqiptar", Vëll. I, Tiranë, 2003, f. 55.

<sup>41</sup> Basileiou, K. Zaride, Grammata apo to Devino (1753-1792) gia to klerodotema tou Spyrou Rizou, në: "Thesaurismata"15, 1978, f. 260-298.

<sup>42</sup> Schmitt, O.J. "Shqiptarët, një histori midis Lindjes dhe Perëndimit", Tiranë, 2012, f. 116.

kulturore e fetare ofruan hapësira për një "kombëtarizim" të kishës ortodokse shqiptare, gjë që u shpreh në botimet e para në shqip dhe në kultivimin e shqipes në shkollat fetare.<sup>43</sup>

Një përhapje kanë shkollat greke në Korçë (1728), në Elbasan (1736), në Vlorë (1741) etj. "Më 1745, në Shkodër, në lagjen Tophanë funksiononte fshehurazi një shkollë (qendër mësimore) me 30 nxënës, e cila drejtohej nga një mësues laik, Jak Kolë Kamsi".<sup>44</sup> Shkolla ishte nën ndikimin e klerit, kurse mësimi ishte laik. Për mësuesin dihen pak gjëra, por i rëndësishëm është fakti se ky mësues nuk dinte gjuhë tjetër veç shqipes, e nuk ka dyshim se mësimet zhvilloheshin në këtë gjuhë.<sup>45</sup>

Shkollat me alfabet grek nivelin më të lartë kulturoro-pedagogjik pikërisht e arritën në Voskopojë. Që në shekullin e XVII jemi ndeshur me dokumente të Voskopojës, që flasin për pagesë mësuesish, për mësues privatë, laikë, për interesime të terzinjve, kasapëve, etj që t'i dërgonin fëmijët në shkollë pa pagesë, nisur nga 200 aspra që kishin siguruar për mësuesin.<sup>46</sup>

Ardhja në pushtet e Bushatllinjve më 1757 dhe sundimi i tyre në Shkodër sollën zhvillime të rëndësishme kulturore e shoqërore. Ata ndërtuan institucionet arsimore si medrese të pajisura me lëndë të ndryshme dhe të drejtuara nga mësues shqiptarë. Biblioteka e ngritur nga Mustafa Pashë Bushati përmbante një fond të pasur librash në disa gjuhë dhe u bë e hapur për publikun. Për të mbështetur nxënësit, u hapën konvikte që ofronin jo vetëm strehim, por dhe edukim, duke krijuar një ansambël të qëndrueshëm dhe të vetëmbajtur që kontribuoi për zhvillimin kulturor dhe arsimor të Shkodrës dhe qëndroi jashtë varësisë direkte të administratës osmane.

Më 1775 një shkollë fillore në Sheldi, një fshat pranë Shkodrës, me mësues D. Nikollë Kançi, ish mësues i Dajçit. Kançi kishte 4 nxënës dhe ishte i kënaqur me ta. Më 1778 thuhet: "Shtëpia e famullisë, e ndërtuar ngjitur me shkollën duke shpenzuar ipeshkvi me klerin dhe tregtarët e Shkodrës 14000 aspra, të tjerë bamirës 9000 aspra...shkolla e ndarë përgjysmë me shkollarët që mësojnë "Participus". Mësues D.Nikollë Kançi nxanës i Propagandës Fide, si famullitar dhe si mësues tre vjet, vjeç 29 (përmenden edhe orenditë shkollore). Mësuesi kishte provizion 50 skuta, gjysmën për vete, gjysmën për nxënës(ushqim, etj.)<sup>47</sup>

Më 1778 për lagjet Palorto e Varosh në Gjirokastrë për të mbajtur në këmbë çerdhet e arsimit gjirokastrit patriotët e mërguar depozituan në bankat e Vjenës shuma të mëdha të hollash, ndërsa Dhimitër Polizoi la në Rumani një shumë të hollash për arsimin.

## Shekulli XIX

"Në vitin 1830 filluan të funksiononin shkollat private katolike, që nën presionin e "Kapitolacioneve" turqit detyroheshin t'i lejonin, kështu që elementi katolik i Shkodrës pati mundësi më të mëdha shkollimi dhe të një kontakti më të madh me gjuhën e shkruar shqipe."<sup>48</sup>

"Shkollat private shqipe kishin traditë të mirë sidomos në Shkodër si nga numri, ashtu nga llojshmëria dhe kohëzgjatja e tyre."<sup>49</sup> Nga viti 1800 deri më 1861 numëroheshin 12 shkolla të tilla, 8 për djem e katër për vajza<sup>50</sup>. "Mjetet ishin të vogla e primitive, prandaj nuk asht për t'u shikjue gjith aq përparimi e dobia, qi xirj prej sosh, sa iniciativa, hapi heroik, zelli për të hapun të kulturës. Një mësues

<sup>43</sup> Xhufi, P. "Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII", "Dukuri të shkollës e të gjuhës në Shqipërinë e Poshtme (shek. XIV-XVIII)", Tiranë, 2013, f. 53-54.

<sup>44</sup> Kadiu, A. "Dibra e Madhe", (monografi), Tiranë, 1996, f. 108-109.

<sup>45</sup> Kabineti pedagogjik i Shkodrës, (1980)"Historiku i arsimit i rrethit Shkodër" pj. I., 1980, f. 7.

<sup>46</sup> MASH, "Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar", Tiranë, 2003, f. 58

<sup>47</sup> Çefa, K. "Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII", "Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVIII", Tiranë, 2013, f. 113.

<sup>48</sup> Luli, F. Dizdari.I, Bushati,N., "Në kujtim të brezave",Shkodër, 1997, f. 84-85.

<sup>49</sup> Koliqi, H., "Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar", Prishtinë, 2012, f. 150.

<sup>50</sup> ASHSH, FESH, (Botim i ri) zëri i hartuar nga H. Koliqi dhe Nj. Kazazi, Tiranë, 2009, Vëll. III, f. 2491.

përfaqësonte një shkollë në vedi. Prindt mezi qi pritshin me i çue fmit e vet në shkollë, bile u zotnoshin me pague edhe mësuesin.”<sup>51</sup>

Shkolla e hapur nga Gjergj Benusi në 1836 shënoi një etapë të rëndësishme në arsimimin në Shkodër, fillimisht duke ofruar mësim në gjuhën italiane dhe më pas në gjuhën shqipe. Gjergji, nga Rivogno d'Istrias, njihej për metodën e tij didaktike, dhe shkolla e tij u konsiderua si më e rregullta deri në atë kohë. Pas tij, i biri, Gaspri (1850-1931), vazhdoi traditën duke mbajtur një shkollë private shqipe për 12 vjet. Nxënësit punonin me fletore, pasi nuk kishte libra, dhe Gaspri kontribuoi në botimin e dy abetareve dhe “Scicibptari i msuem n’ghiuh t’vet” (1890), e cila përmirësoi lëndën dhe u vlerësua për bukurinë e gjuhës shqipe. Ai ribotoi veprën në 1897 me disa përmirësime, duke e bërë atë të nevojshme për shkollat dhe popullin.

Në vitin 1855, françeskanët hapën një shkollë në lagjen Gjuhadol të Shkodrës. Kjo shkollë, e njohur si “Shkolla Fretnore,” përjetoi përparime të mëdha. Raporti i Konsullatës Austriake në Shkodër më 4 korrik 1863 theksonte se shkolla, e drejtuar nga misionarët françeskanë, ndante mësimin në katër klasë dhe ofronte lëndë si besimi, aritmetika, kaligrafia dhe elemente të gramatikës italiane. Në 1867, për shkak të rritjes së numrit të nxënësve, kërkohesh shtimi i ndihmës financiare nga qeveria, e cila u pranua, duke siguruar rrogat për më shumë mësues. Shkolla vazhdoi të rritej në numrin e nxënësve dhe, me ndihmën e qeverisë austriake, një ndërtesë më të përshtatshme u ndërtua në 1877. Kjo shkollë jo vetëm që u zhvillua në aspektin mësimor, por gjithashtu organizoi aktivitete kulturore, duke përfshirë ndërtimin e një salla teatri për shfaqje. Më 1899, u përpiluan programe të reja dhe mjetet mësimore u modernizuan, duke reflektuar rritjen e vazhdueshme të shkollës dhe angazhimin për arsimimin e fëmijëve.

Shkolla françeskane në Shkodër punoi deri në vitin 1902, kur në krye të saj erdhi At Gjergj Fishta. Me ardhjen e tij, shkolla filloi të përdorë gjuhën shqipe si gjuhë mësimi në të gjitha lëndët, duke i dhënë një frymë kombëtare institucionit. Fishta hoqi gjuhën italiane dhe shtoi klasat qytetëse sipas programit austriak. Në kohën e tij, shkolla arriti të ketë deri në 300 nxënës dhe përparoi në aktivitete kulturore, duke organizuar shfaqje teatrale që ndihmonin në ngjalljen e ndjenjave kombëtare. Më 1909, shkolla u njoh zyrtarisht nga Porta e Lartë dhe u afruan mësues civilë të përgatitur mirë. Gjatë periudhës së Fishtës, shkolla përmirësoi programin mësimor dhe numri i klasave u rrit. Biblioteka e themeluar në 1907 nga Fishta dhe Gjeçovi luajti një rol të rëndësishëm në arsimimin e nxënësve, duke ofruar mbi 15,000 vepra për studim.

Në vitin 1877, një grup prej 22 qytetarësh katolikë nga Shkodra kërkuan hapjen e një shkolle të mesme për të adresuar nevojën për arsimim dhe shqetësimin për mungesën e mjeteve financiare. Më 17 tetor 1877, u organizua një mbledhje për prezantimin e Kolegjit Saveriane të Jezuitëve, e cila, deri në vitin 1888, evoluoi në një gjimnaz të vërtetë. Gjatë viteve, shkolla ofroi profile të ndryshme, përfshirë ato reale, teknike dhe tregtare, duke ruajtur një theks klasik.

At Luigj Mazza shërbeu si zv/ректор i parë dhe më pas rektor, duke kontribuar në zhvillimin e shkollës. Austro-Hungaria ofroi subvencione për shkollën, e cila ofronte mësim falas dhe më pas u subvencionua nga Italia pas vitit 1919. Shkolla mbante një plan mësimor të pasur, me një theks të veçantë në lëndët shoqërore, shkencat natyrore dhe edukimin fizik. Biblioteka e shkollës kishte veprat e autorëve të njohur dhe një shtypshkronjë që botoi libra në shqip, duke kontribuar në zhvillimin e kulturës shqiptare. Muzeu i shkollës, i pasur me koleksione etnografike dhe numizmatike, ndihmoi në rritjen e krenarisë kombëtare të nxënësit. Veprimtaritë kulturore dhe ushtrimet gjimnastike kontribuan në edukimin estetik dhe atdhetar të nxënësve. Kolegji Saverian arriti të edukonte nxënës të besimeve të

<sup>51</sup> Kurti, D., O.F.M. "Vepra kulturore e elementit katolik në Shqipëri", Shkodër, 1935, f. 11.

ndryshme, ofroi një arsimim të gjerë, përgatiti nxënës për shkollat europiane dhe pati një ndikim të rëndësishëm në formimin e elitës shqiptare.

Pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, shkrimi i gjuhës shqipe vazhdoi të mësohej fshehurazi në vise të ndryshme të Shqipërisë. Elementë të shtresave të ndryshme, çirakë, zanatçinj, të pasur, të varfër, të rinj e të moshuar, në bodrume, nëpër shtëpi, nëpër shkolla në gjuhë të huaj, në qytete e në malësi, me libra e pa libra filluan të mësojnë shkrimin e gjuhës shqipe. Koto Hoxhi largohet nga Stambolli, vjen në vendlindjen e tij, në Qestorat dhe punon për të përhapur mësimin shqip në të rinj e në të moshuar<sup>52</sup>. Koto Hoxhi tërhoqi rreth vetes nxënës shqiptarë të shkollës normale greke të Qestoratit, u dha mësim në orët e lira.

Shembullin e tij e ndoqën edhe nxënësit e tij. Një nga ato ishte edhe Petro Nini Luarasi, në atë kohë 17 vjeçar, ndonëse punonte mësues i greqishtes në fshatrat Bezhan të Kolonjës, Katund, Luaras, gjatë viteve 1882-1887 u bë një përhapës energjik dhe i guximshëm i gjuhës Shqipe dhe "e ktheu shkollën greqishte, pothuajse krejt shqip".

Thimi Mitko (1820-1890) u përpoq të hapë një shkollë shqipe në Korçë, në fund të viteve '50, por u ndalua nga Porta e Lartë dhe Patriarkana. Anastas Byku, i cili veprroi në vitet 1859-1878, punoi për krijimin e një rrjeti shkollash në gjuhën shqipe dhe botoi një abetare "Gramë për shqiptarët", në të cilin përdorej alfabeti greqisht për shkrimin e shqipes.

Më 1851 Panajot Dhimua nga Gjirokastra, me të hollat e veta, që kish të fituar me djersë duke punuar në Stamboll, ngriti në lagjen Varosh shkollën e vajzave.<sup>53</sup> Në këtë shkollë ai dëshironte arsimimin e vajzave "pa dallim feje".

Në kushtet që po kalonte vendi ynë, problemi i arsimimit të femrës ishte bërë një nevojë e domosdoshme e kohës. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim kanë luajtur shkollat femërore të hapura në Shkodër, Korçë, Pogradec etj.<sup>54</sup>

"Shkolla e Kushë Mices" u themelua në vitin 1859 nga mësueset Kushë Micja dhe Tereza Berdica si një qendër mësimore private për vajzat. Kjo shkollë luajti një rol të rëndësishëm në përhapjen e arsimit femëror shqiptar dhe qëndroi e hapur deri në vitin 1897. Kushë Micja, e frymëzuar nga dashuria për gjuhën dhe kulturën shqiptare, e hapi shkollën nën moton "Kurrëgjia për vete dhe gjithçka për të tjerët". Ajo kishte mbi 50 nxënës me moshë nga 9 deri në 14 vjeç, dhe ofronte lëndë si këndim, shkrim, numërore, vizatim, këngë dhe punë dore. Mësimi zhvillohej në klasa kolektive, me orare të thjeshta.

Një dokument i vitit 1865 përmban emrat e 86 nxënësve, duke treguar angazhimin e shkollës. Disa nxënës, si Maria Mici dhe Tina Nika, u vlerësuan për pjekurinë dhe sjelljen e tyre. Shkolla u mbyll në vitin 1897, kur Kushë Micja u tërhoq për arsye të moshës, duke lënë pas një trashëgimi të rëndësishme për arsimin femëror në Shqipëri.<sup>55</sup>

Tereza Berdica hapi "Shkollën e Tereze Berdicës" në vitin 1862, në shtëpinë e saj në rrugën Daullej, duke ofruar edukim për vajza nga moshë 7 deri në 14 vjeç, kryesisht nga familje të varfra. Ajo shpesh nuk kërkonte pagesë mujore për mësimin, i cili zhvillohej në një dhomë të shtëpisë. Tereza punoi për 33 vjet në këtë shkollë, ku ndihmohej nga Kushë Micja, e cila kontribuonte në organizimin e çështjeve shkollore. Ajo i mësonte nxënësve shkrim dhe këndim në gjuhën shqipe, si dhe lëndë të tjera. Në vitin 1895, Tereza u angazhua si kujdestare në një shkollë italiane, ndërsa nxënëset e saj u shpërndanë në shkollën e Kushës, të Tinës dhe në shkollën italiane.<sup>56</sup>

<sup>52</sup> Papapano, TH., "Shkollat e para shqipe në rrethin e Gjirokastrës", Arsimi Popullor, Nr.3, 1963, f. 69.

<sup>53</sup> Thoma Papapano "Shkollat e para shqipe në rrethin e Gjirokastrës", Arsimi Popullor", Nr. 3, 1963, f. 68.

<sup>54</sup> Shllaku, L. Shkollat Klerikale, Shkodër, 2002, f. 82.

<sup>55</sup> Grup autorësh, MASH,ISP, "Historia e Arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar", Vëllimi i I, Tiranë. 2003, f. 97

<sup>56</sup> Gjyshja, T., "Shkollat e para femërore në Shkodër deri në vitin 1912", Arsimi Popullor, Nr.3,1963, Tiranë, f. 62

"Shkolla e Tinës së Nikës" u hap në vitin shkollor 1873-74. Të paktën për shtatë vjet, Tereza Nika e drejtoi këtë shkollë, duke pranuar disa vajza pa pagesë dhe të tjera për një shpërblim të vogël. Ajo shkroi për arqipeshkun Pashko Guerini, duke theksuar përkushtimin e saj për edukimin e vajzave, pavarësisht vështirësive, duke vazhduar të ofronte mësim me energji dhe përkushtim. Guerini, i njohur si arqipeshkvi i shkollave shqipe, e vlerësonte këtë iniciativë.<sup>57</sup>

Tina Nika, e cila kishte qenë nxënëse e Kushe Micës për tetë vjet, hapi shkollën e saj, e cila arsimonte vajza dhe djem. Ajo drejtoi shkollën për 50 vjet, së bashku me motrën e saj Gjystja, duke ofruar një arsimim të ngjashëm me atë të mësueses së saj. Shkolla mbështetej në kontributet e prindërve dhe përfshinte një program mësimor që përfshinte shkrim dhe këndim shqip. Arqipeshkvi Pashko Guerrini monitoronte zhvillimin e shkollës dhe shpërndante çmime për nxënësit më të mirë. Megjithatë, më 1920, shkolla përballej me probleme financiare dhe kërkoi ndihmë nga Ministria e Arsimit, por pa sukses. Në 1923, shkolla u bë "Shkolla Fillore Serreq" dhe u mbështet nga shteti deri në vitin 1933, kur u shtetëzuan shkollat private. Tina përballi rënien e regjistrimeve pas hapjes së shkollave italiane në 1889 dhe vazhdoi të përpiquej për të rritur numrin e nxënësve, duke arritur që në 1906 të kishte 51 vajza të varfëra të regjistruara.

Kontributi i këtyre shkollave ka qenë i madh sa që mund të themi "... se gratë në Shkodër edhe para njiqind e më vjetve (bëhet fjalë për shekullin e XIX, shënimi ynë) shkrueshin shqip"<sup>58</sup>. Krahas dëshmimeve të njohura deri tani, një tjetër dëshmi që na ka rënë në dorë janë disa shënime, në një teftër (blok, shënimi ynë) me faqe të zverdhura në të cilin përshkruhet shqip mënyra se si duhet të gatuheshin gjellët e ëmbëlsirat. Nuk është qëllimi për të dhënë mënyrën e gatimit, por aty në rreshta të shkruar me grafin e dikurshme të shqipes, nëna bashkë me pajën i vendoste në arkë së bijës, që shkonte nuse, edhe shënime, mësim si të sillej në shtëpinë e burrit. Kuptohet se gatimet kanë një rëndësi të madhe në jetën familjare, prandaj i është kushtuar një rëndësi të madhe mënyrës të të përgatiturit të tyre. Ortografia është ajo e librave të moçëm, botuar në Shkodër gjatë shekullit të XIX.

Përveç këtyre shkollave, pati edhe të tjera shkolla femërore në gjuhën shqipe, si shkolla e Stigmatineve (1878), e Kallmetit (1896), azili i motrave servite apo streha foshnjore në qytet (1898), shkolla plotore për vajza (1906). Po kështu më 1907 u hap në Shirokë një shkollë fillore femërore, kurse me 1911, në Kallmet një shkollë fillore jo e plotë për vajza. Si rezultat i këtyre shkollave një pjesë e mirë e grave dhe vajzave të qytetit tonë dinin të shkruanin e të lexonin. Më 2 prill 1881 treqind nxënëse të shkollave të qytetit të Shkodrës i dërguan Dora d'Istries (princeshës Elena Gjika) një penë të argjendte dhe një letër me 300 nënshkrimet e tyre.<sup>59</sup>

Studiuesi Jup Kastrati në një shkrim të tij na njuh me një fakt interesant: Ai thekson "se deri në shpalljen e Pavarësisë, në rrethin e Shkodrës, kishte 47 shkolla shqipe, nga të cilat 10 për vajza".<sup>60</sup>

Për arsimin në Shkodër Dom Ndoc Nikaj në librin e tij "Kujtime të një jetës së kalueme" ndër të tjera shkruan: "Para se të vinin në Shkodër Jezuitët, Fretnit e Stimatinet patne kenë dy msojtore varzash nën drejtimin e dy murgeshave shtëpiake: Kush Micja e Treze Berdicia qi nepshin një nduer mësimi sa me dijt me këndue e me shkruë, në mos tjetër se e cilla e varzave emnin e vet edhe per djelmt pat kenë një i quejtun Ndoc Speci e ma vonë Benushi".<sup>61</sup>

<sup>57</sup> AMSH, Letër drejtuar Guerinit më 9 mars 1881, Arkivi i Muzeut të Shkodrës, fondi i arsimit

<sup>58</sup> Ernest Koliqi "Gjellë e ëmbëlsina të vendit tonë", "Shejzat", I, Nr 1-4, viti 1972, f. 62

<sup>59</sup> Kastrati, J., "Kontribut për historinë e arsimit në rrethin e Shkodrës deri në vitin 1912", Arsimi Popullor, Tiranë, 1963, f. 72

<sup>60</sup> Kastrati, J., "Kontribut për historinë e arsimit në rrethin e Shkodrës deri në vitin 1912", Arsimi Popullor, Tiranë, 1963, fq. 72

<sup>61</sup> Nikaj, N, 2003, fq. 36

Shkolla fillore e Stigmatineve u hap në vitin 1879 nga motrat Stigmatine, të sjella në Shkodër nga françeskanët. Fillimisht, shkolla kishte 200 nxënës dhe tre mësuese, duke funksionuar si një institucion privat që ofronte mësim në gjuhën shqipe. Në vitin 1888, numri i nxënësve arriti në 428, përfshirë vajza jetime dhe murgesha, disa prej të cilave më pas u bënë mësuese.

Shkolla fillore përfshinte dy klasa të ulta dhe, përveç shkrim-këndimit, ofronte mësim në punë dore, matematikë, histori, gjeografi, gjimnastikë dhe muzikë. Një poezi e asaj kohe lavdëronte arritjet e shkollës dhe rëndësinë e saj për vajzat shkodrane, pavarësisht besimit dhe origjinës.

Më 1896-1897, shkolla kishte katër klasa dhe një numër nxënësish deri në 400. Provimet përfundimtare përfshinin lëndë të ndryshme si doktrina e krishterë, shkrim, matematikë dhe histori. Ky institucion kishte një ndikim të rëndësishëm në arsimin e vajzave, duke kontribuar në zhvillimin e arsimit në rajon.

## Konkluzione

Historia e shkollës shqipe gjatë shekujve XVII-XIX dëshmon për përpjekjet e vazhdueshme të shqiptarëve për të ruajtur gjuhën, kulturën dhe identitetin kombëtar përmes arsimit. Institucionet fetare, veçanërisht kishat katolike dhe ortodokse, ishin themelore në krijimin e shkollave të para shqipe, ndërkohë që intelektualët dhe misionarët shqiptarë luajtën një rol kyç në përhapjen e arsimit dhe vetëdijes kombëtare. Përkundër sfidave të mëdha, si asimilimi kulturor nga fuqitë e huaja dhe kufizimet e vendosura nga Perandoria Osmane, shkollat shqipe mbijetuan falë organizimit privat dhe fshehtë, duke ndihmuar në ruajtjen e një ndjenje të përbashkët kombëtare. Gjithashtu, hapja e shkollave femërore si një hap emancipues tregoi për përpjekjet për një arsim gjithëpërfshirës. Këto përpjekje arsimore shërbyen si pararendëse për zhvillimin e arsimit modern në Shqipëri, duke krijuar një trashëgimi të pasur për brezat e ardhshëm. Ky rrugëtim është shembull i përkushtimit për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës shqipe, si dhe mbrojtjen e identitetit kombëtar.

## Referenca

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2009). *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* (botim i ri, zëri i hartuar nga H. Koliqi dhe Nj. Kazazi, Vëll. III). Tiranë: ASHSH.
- Basileiou, K. Zaride. (1978). *Grammata apo to Devino (1753–1792) gia to klerodotema tou Spyrou Rizou. Thesaurismata*, 15
- Çefa, K. (2013). Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII. Në *Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI–XVIII*. Tiranë.
- Çelebi, E. (1930). *Seyahatname: Shqipëria para dy shekujsh*. Tiranë.
- Dedei, S. (1999). Zhvillimi i arsimit në Mesjetë në Shqipëri. *Revista Pedagogjike*, 2. Tiranë.
- Dituria. (1927). Françeskanët në Shqipëri. *Dituria*, 3(3). Tiranë.
- Gjergji, S. (2013). Stublla me Kolegjin e Shën Lukës, 1584. Në *Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI–XVIII*. Tiranë.
- Grup autorësh (MASH, ISP). (2003). *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar* (Vëll. I). Tiranë: MASH & ISP.
- Gurakuqi, K. (1928). Françeskanët në Shqypni. *Dituria*, 3.
- Kabineti Pedagogjik i Shkodrës. (1980). *Historiku i arsimit në rrethin Shkodër* (Pjesa I).
- Karalewskij, C. (1911). La missione greco-cattolica della Cimarra nell'Epiro nei sec. XVI–XVII. *Bessarione*, XV(2).
- Kastrati, J. (1964). Tekste të vjetra shkollore. *Arsimi Popullor*, 6.
- Kazazi, Nj. (2014). Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër. Shkodër.
- Koliqi, H. (1972). Gjellë e ambëlsina të vendit tonë. *Shejzat*, I(1–4).
- Koliqi, H. (2012). *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*. Prishtinë.
- Kurti, D., & Sirdani, M. (1999). Mbi kontributin e elementit katolik në Shqipëri. Tiranë.
- Luka, D. (2013). Shkolla shqipe e Kurbinit. Në *Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI–XVIII*. Tiranë.
- Marko, P. (1963). Shkolla e parë shqipe tre shekuj më parë. Në *Fletë nga historiku i shkollës*. Tiranë.

- MASH (Ministria e Arsimit dhe Shkencës). (2003). *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar* (Vëll. I). Tiranë.
- Mons Spila. *Memorie storiche della Provincia Romana* (Tom. II).
- Nikaj, N. (2003). *Kujtime të një jete të kaluar*.
- Orbis Seraphicus, P. Marcellinus a Civetia, & Domenichelli, T. (O.F.M.). *De Miss, FF. Minorum*.
- Osmani, Sh. (1998). *Reflekse etnopedagogjike 1*. Tiranë.
- Papapano, Th. (1963). Shkollat e para shqipe në rrethin e Gjirokastrës. *Arsimi Popullor*, 3.
- Prendushi, M. (1974). Vështrim historik mbi zhvillimin e arsimit në Shkodrën e shekullit XIX. *Studime Historike*, 3.
- Rexhepagiq, J. (1970). *Zhvillimi i arsimit dhe sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*. Prishtinë.
- Schmitt, O. J. (2012). *Shqiptarët: Një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. Tiranë.
- Sedaj, E. (1999). Ndre Bogdani – prelat i lartë i Kishës dhe mësues i popullit shqiptar. *Dardania Sacra*, 1. Prishtinë.
- Sinani, A. (2024, 6 qershor). Kongresi i Manastirit – 116 vite nga alfabeti që na bashkoi: Dokumente arkivore, artikuj dhe fotografi. *Monografi Akademike Shqiptare*.
- Skura, M. (1965). Relacion i Mark Skurës drejtuar Kongregacionit të Propagandës Fide mbi vizitën e kryer nëpër dioqezat e Shqipërisë së Mesme (Vëll. II, 1634–1650). Në *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme shek. XVII*. Tiranë.
- Shllaku, L. (2002). *Shkollat klerikale*. Shkodër.
- Xhufi, P. (2013). Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII. Në *Dukuri të shkollës e të gjuhës në Shqipërinë e Poshtme (shek. XIV–XVIII)*. Tiranë.